

Tirane me 16/06/2014

**Unioni i Gazetareve Shqiptare denon ashper sulmin dhe dhunen e ushtruar ne Lazarat mbi gazetarin Gerti Xhaja si dhe shkaterrimin e mjeteve te punes te gazetareve dhe stafit raportues te A1 Report**

Unioni i Gazetareve Shqiptare eshte informuar per sulmin e kryer sot ne Lazarat, mbi stafin e raportimit te TV A1 Report, dhe mbi reporterin Gerti Xhaja. Reporteri Xhaja dhe stafi shoqerues te gjendur nen sjelljen e dhunshme te personave, kane rrezikuar seriozisht ne emer te detyres, nderkohe qe jo larg vendit te dhunes se ushtruar ka pasur forca policie. Automjeti me te cilin gazetari Xhaja udhetonte eshte shkaterruar, nderkohe qe mbi gazetarin dhe stafin e tij eshte ushtruar dhune fizike, deri ne gjakosje. Nga kjo sjellje e dhunshme eshte rrezikuar seriozisht integriteti fizik i gazetarit.

Unioni i Gazetareve Shqiptare denoncon kete dhune dhe kerkon me force venien para pergjegjesise ligjore te personave dhe protagonisteve te kesaj ngjarjeje. UGSH kerkon nga autoritetet ligjore ne vend te shumefishojne gjithë preokupimin e tyre per te garantuar jeten dhe lirine e gazetareve per raportim nga mjedise dhe ngjarje, ne vecanti, ne vende ku kriminaliteti sfidon hapur ligjin dhe shtetin.

Unioni i Gazetareve Shqiptare inkurajon koleget per mosterheqje nga detyra dhe apelon per rritje te kujdesit dhe te kurajos per te pasqyruar ne cdo kohe dhe kurdo te vertetat, aq me teper ato qe lidhen me boten dhe veprimtarine e kriminit.

Organizata jone shpreh mbeshtetjen per te gjithë gazetarët qe raportojne nga situata dhe terreni i veshtire ne zonen e Gjirokastrës. UGSH shpreh fuqimisht inkurajimin si dhe solidaritetin e plote me kogelun Gerti Xhaja, duke e vleresuar per punen dhe kurajon e tij profesionale. Unioni i Gazetareve Shqiptare vlereson se siguria per ushtrim te lire te veprimtarise se reportereve dhe mediave ne Lazarat mbetet kritike.

Zyra e Shtypit  
Unioni i Gazetareve Shqiptare